



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

në mes të:

UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA "

dhe

QENDRA PËR MIRËQENIEN E GRUAS

Në frymën e zhvillimit të një edukimi universitar sa më të afërt me tregun e punës, me datën 02/10/2023 Universiteti i Pejës "Haxhi Zeka " (më poshtë si "Universiteti"), i përfaqësuar nga Rektori Prof. Ass. Dr. Armand Krasniqi dhe Qendra për Mirëqenien e Gruas (më poshtë si "INSTITUCIONI"), përfaqësuar nga Ardita Ramizi Bala, hynë në një marrëveshje bashkëpunimi ndërinstitucionale.

Qëllimi i marrëveshjes

I.

Qëllimi i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi është zhvillimi i aftësisë praktik gjatë dhe pas studimeve, përkatësisht të bëjë lidhshmërinë e mësimnxënies teorike me punë praktike, për arritje më të mëdha dhe avancim të diturisë, të parapara me planet dhe programet mësimore të Universitetit, por edhe dobiprurëse për një progres më të mirë shoqëror.

Qendra për Mirëqenien e Gruas si pjesë e programit rajonal "SMART Balkans", së bashku me organizatën SOS Hotline Për Gratë dhe Fëmijët Viktima të Dhunës Niksic, (Mali i Zi) dhe Forumi i Gruas Elbasan (Shqipëri) janë duke zbatuar, së bashku, projektin ndërkufitar të quajtur "Zbatimi i përmirësuar i Konventës së Stambollit në Rajonin e Ballkanit Perëndimor". Ky projekt realizohet me ndihmën e projektit rajonal "SMART Balkans - Shoqëria Civile për Vlera të Përbashkëta në Ballkanin Perëndimor", e që ka qenë i zbatuar nga Qendra për Promovimin e Shoqërisë Civile (CPCD), Qendrën për Hulumtim dhe Politikë-bërje (CRPM) dhe Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), të mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme e Norvegjisë (NMFA).

Objektivi i marrëveshjes

II.

Objektivi i marrëveshjes është:

- I. Realizimi i vëzhgimit praktik të studentëve të Universitetit gjatë studimeve dhe pas studimeve, në biznes/INSTITUCION.
- II. Zhvillimi i temave të diplomës duke ju mundësuar studentëve, krahas udhëheqjes teorike/shkencore, udhëheqjen praktike të punës së diplomës në organizatë,
- III. Angazhimin e Universitetit në zgjidhjen e problemeve praktike/shkencore të institucionit.
- IV. Hulumtimet e ndryshme ku pjesëmarrës mund të jenë studentët dhe stafi i UHZ-së.

- V. Realizimi i prezantimeve te programeve parandaluese te DHBGJ dhe hulumtimeve te realizuara nga QMG-Pejë
- VI. Aktivitete te tjera me interes te perbashket ne mes te dy institucioneve.

III.

Mënyra e realizimit të marrëveshjes

- Studentët e Universitetit nga 5 fakultetet e kyqura do të përfitojnë aftësimin praktik rreth Konventës së Stambollit
- Gjatë tërë kohës së prezantimit, studentët do të jenë të udhëhequr nga mësuesit e lëndëve adekuate teorike, duke perfituar njohuri praktike nga organizata.
- Studentët mund të pyesin personelin mësues apo përfaqësuesin e institucionit për atë çka u intereson, rreth projektit dhe te gjitha aktiviteteve te QMG strehimores.
- Studentet do te paisen me material edukative per kohen te cilen do te kalojne ne prezantime.

IV.

Studenteve do ju mundësohet të vizitojnë punen praktike në strehimore, vëzhgimit praktik apo gjatë përgatitjes së temave të diplomave për secilin individ i cili futet brenda objektivit të institucionit përgjegjësia është individuale.

V.

Për angazhime të ndryshme praktiko/shkencore, institucioni mund të angazhojë Universitetin në ofrimin e zgjidhjeve të mundshme aplikative.

Efekti i marrëveshjes

Marrëveshja shtrinë efekt që nga dita e nënshkrimit nga palët.

Ndërprerja e marrëveshjes


Kohëzgjatja e marrëveshjes është e limituar në 5 vite, ndërsa mund të shkëputet me paralajmërim paraprak prej 30 ditësh nga cilado palë nënshkruese.

Për:

Universiteti "Haxhi Zeka"

Për:

Qendra për Mirëqenien e Gruas


Prof. Dr. Armand Krasniqi
Rektor


MA Ardita Ramizi Bala



Pejë, më: Shtator 2023

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERSITETI "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
Nr. / Dr. / No. <u>2985</u>	Nr. / faq. / Br. / str / No. / pg <u>2</u>	
Data / Datum / Date: <u>13/10/2023</u>		

Faça 2 prej 2